



OLIMPIADA KOMBËTARE E KIMISË  
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Klasa 11

Faza e dytë

Viti shkollor 2023-2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përbën 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë				
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....

2.....

1. Më poshtë janë dhënë dy skema që përshkruajnë reaksione të magnezit.

Shkruani 10 barazimet kimike që u përkasin reaksioneve të përshkruara në skemat I dhe II.

Skema I:

- a) Kur digjet magnezi oksigjeni, formohet një përbërje e ngurtë e bardhë (A).  
 b) Kur përbërja A tretet në tretësirën 1 M HCl formohet një tretësirë pa ngjyrë (B).  
 c) Me shtimin e  $\text{Na}_2\text{CO}_3$  në tretësirën B, formohet një precipitat i bardhë (C).  
 d) Me ngrohje, përbërja C zbërthehet në D dhe krijohet një gaz më pak ngjyrë (E).  
 e) Kur kalohet përbërja E në ujë gëlqeror [një tretësirë ujore e  $\text{Ca}(\text{OH})_2$ ], shfaqet precipitat i bardhë (F).

**5 pikë**

Skema II:

- a) Magnezi vepron me tretësirën 1 M  $\text{H}_2\text{SO}_4$  përfshirë pa prodhuar një tretësirë pa ngjyrë (G).  
 b) Trajtimi i G me një tepricë të  $\text{NaOH}$  prodhon një precipitat të bardhë (H).  
 c) H tretet në tretësirën 1 M  $\text{HNO}_3$  përfshirë pa formuar një tretësirë pa ngjyrë. Kur tretësira avullohet ngadalë, përfshirë pa prodhuar një përbërje e ngurtë e bardhë (I).  
 d) Me ngrohjen e përbërjes (I), veçohet një gaz me ngjyrë kafe J.  
 e) Kur gazi J tretet në ujë të distiluar formohet tretësirë ujore e dy përbërjeve K dhe L.

**5 pikë**

### Zgjidhje

Skema I

- a)  $2\text{Mg} + \text{O}_2 \rightarrow 2\text{MgO}$   
 b)  $\text{MgO} + 2\text{HCl} \rightarrow \text{MgCl}_2 + \text{H}_2\text{O}$   
 c)  $\text{MgCl}_2 + \text{Na}_2\text{CO}_3 \rightarrow \text{MgCO}_3 + 2\text{NaCl}$   
 d)  $\text{MgCO}_3 \rightarrow \text{MgO} + \text{CO}_2$   
 e)  $\text{CO}_2 + \text{Ca}(\text{OH})_2 \rightarrow \text{CaCO}_3 + \text{H}_2\text{O}$

Skema II

- a)  $\text{Mg} + \text{H}_2\text{SO}_4 \rightarrow \text{MgSO}_4 + \text{H}_2$   
 b)  $\text{MgSO}_4 + 2\text{NaOH} \rightarrow \text{Mg}(\text{OH})_2 + \text{Na}_2\text{SO}_4$   
 c)  $\text{Mg}(\text{OH})_2 + 2\text{HNO}_3 \rightarrow \text{Mg}(\text{NO}_3)_2 + 2\text{H}_2\text{O}$   
 d)  $2\text{Mg}(\text{NO}_3)_2 \rightarrow 2\text{MgO} + 4\text{NO}_2 + \text{O}_2$   
 e)  $\text{NO}_2 + \text{H}_2\text{O} \rightarrow \text{HNO}_2 + \text{HNO}_3$

$$\begin{aligned} A &= \text{MgO} & B &= \text{MgCl}_2(\text{uj}) \\ C &= \text{MgCO}_3 & D &= \text{MgO}, \quad E = \text{CO}_2 \\ F &= \text{CaCO}_3 \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} G &= \text{MgSO}_4(\text{aq}) & H &= \text{Mg}(\text{OH})_2 \\ I &= \text{Mg}(\text{NO}_3)_2 & J &= \text{NO}_2 \\ K &= \text{HNO}_2, \quad L = \text{HNO}_3 \end{aligned}$$

2. Në laboratorin e kimisë dy grupe nxënësish duhet të realizonin dy detyra eksperimentale që i përkasin reaksioneve redoks dhe elektrokimisë, si dhe njehsimet përkatëse:

**I. Grupi A:**

- Një tretësirë me vëllimin 25 mL që përmban dy lloj kationesh  $\text{Fe}^{2+}$  dhe  $\text{Fe}^{3+}$  e titulluan me 23 mL tretësirë 0,02 M  $\text{KMnO}_4$  (në praninë e acidit sulfurik të holluar). Gjatë titullimit të gjithë jonet  $\text{Fe}^{2+}$  oksidohen në jone  $\text{Fe}^{3+}$ .
- Më pas, tretësirën e formuar pas titullimit e trajtuan me metal Zn për të kthyer të gjithë jonet  $\text{Fe}^{3+}$  në jonet  $\text{Fe}^{2+}$ .
- Së fundi, 40 mL të së njëjtës tretësirë  $\text{KMnO}_4$  i shohen tretësirës së krijuar në pikën (b) për të oksiduar jonet  $\text{Fe}^{2+}$  në jonet  $\text{Fe}^{3+}$ .

Njehsoni përqendrimet molare të joneve  $\text{Fe}^{2+}$  dhe  $\text{Fe}^{3+}$  në tretësirën fillestare.

6 pikë

**II. Grupi B:**

Në një eksperiment të elektrolizës, ku u lidhën në seri dy "qeliza" elektrolitike, njëra me tretësirë ujore të nitratit të argjendit dhe tjetra me tretësirë ujore të klorurit të një metali të panjohur  $\text{XCl}_3$ , u përcaktua që në "qelizën" e parë u depozituan 2,88 gram Ag, ndërsa në "qelizën" tjeter u depozituan 0,462 gram të metalit të panjohur X

- Njehsoni masën atomike të metalit X.


- Njehsoni vëllimin e klorit që grumbullohet në qelizën e dyti. (referuar kushteve normale) ( $\text{A}_{\text{Ag}}=108$ )

2 pikë

2 pikë

### Zgjidhje

**I. Grupi A:**




$$n_{\text{MnO}_4^-} = 0,02 \times 0,023 = 0,00046 \text{ mol}$$

$$[\text{Fe}^{2+}]_{\text{fillesstar}} = \frac{0,0023}{0,025} = 0,092 \text{ M}$$

$$n \text{ Fe}^{2+} = 0,0046 \times 5 = 0,0023 \text{ mol}$$

Për të gjetur përqendrimi total të hekurit duhet të kemi parasysh që pas reduktimit me zink përdoret i njëjtë vëllim i mostrës (25 mL) dhe përdoret tretësira e  $\text{KMnO}_4$  me të njëjtin përqendrim.



$$n_{\text{MnO}_4^-} = 0,02 \times 0,04 = 0,0008 \text{ mol}$$

$$n \text{ Fe}^{2+} = 5 \times n_{\text{MnO}_4^-} = 5 \times 0,0008 = 0,004 \text{ mol total}$$

$$[\text{Fe}^{2+}]_{\text{total}} = \frac{0,004}{0,025} = 0,16 \text{ M} = [\text{Fe}^{2+}]_{\text{total}} (\text{pas titullimit të parë})$$

$$[\text{Fe}^{2+}]_{\text{total}} - ([\text{Fe}^{2+}] (\text{në titullimin e parë}) = 0,16 - 0,092 = 0,068 \text{ M} = [\text{Fe}^{3+}]_{\text{fillestar}}$$

**II. Grupi B:**


- $\text{K} (-): 3\text{Ag}^+ + 3\text{e}^- = 3\text{Ag}^\circ$   
 $\text{K} (-): \text{X}^{3+} + 3\text{e}^- = \text{X}^\circ$

(qeliza elektrolitike 1)

(qeliza elektrolitike 2)

$$\frac{3 \times 108 \text{ g Ag}}{2,88 \text{ g}} = \frac{\text{AX}}{0,462 \text{ g X}} \quad \text{AX} = 51,97$$

- $\text{K} (-): 2\text{X}^{3+} + 6\text{e}^- = 2\text{X}^\circ$



$$2 \times 51,97 \text{ g X} \rightarrow 3 \times 22,4 \text{ L Cl}_2$$

$$0,462 \text{ g X} \rightarrow V_{\text{Cl}_2} \quad V_{\text{Cl}_2} = 0,298 \approx 0,3 \text{ litra}$$

3. Konstanta e ekuilibrit  $K_c$  për reaksiionin:  $H_{2(g)} + I_{2(g)} \leftrightarrow 2HI(g)$   $\Delta H < 0$  është 54.3 në 430°C. Në fillim të bashkëveprimit në një kontenier me vëllimin 2,4 Litra vendosen 0,714 mole  $H_2$ , 0,984 mole  $I_2$  dhe 0,886 mole  $HI$ .
- Njehsoni përqendrimet e gazeve në ekuilibër. 5 pikë
  - Analizoni ndryshimet që duhet të bëhen në lidhje me përqendrimet, trysninë dhe temperaturën në mënyrë që ekuilibri i mësipërm të zhvendoset majtas. 3 pikë
  - Shkruani barazimet e shpejtësisë (ekuacionet kinetike) për reaksionet përkatëse në ekuilibrin e mësipërm. 2 pikë

a) Gjejmë përqendrimet fillestare të përbërjeve në reaksiionin e dhënë:

$$[H_2]_0 = \frac{0,714\text{mol}}{2,4L} = 0,298 \text{ M}$$

$$[I_2]_0 = \frac{0,984\text{mol}}{2,4L} = 0,41 \text{ M}$$

$$[HI]_0 = \frac{0,886\text{mol}}{2,4L} = 0,369 \text{ M}$$

Njehsojmë koeficientin  $Q$  me përqendrimet fillestare dhe duke e krahasuar me konstanten e ekuilibrit  $K_c$  përcaktojmë ecurinë e reaksiionit deri në momentin e ekuilibrit kimik:

$$Q = \frac{[HI]^2}{[H_2][I_2]} = \frac{(0,369)^2}{(0,298)(0,41)} = 1,11$$

$$Q < K_c$$

Deri në ekuilibër ka përparsi reaksiioni I drejtë.

	[ $H_2$ ]	[ $I_2$ ]	[ $HI$ ]
fillimi	0,298	0,41	0,369
ndryshimi	- $x$	- $x$	+ 2 $x$
ekuilibër	(0,298 - $x$ )	(0,41 - $x$ )	(0,369 + 2 $x$ )

$$K_c = \frac{[HI]^2}{[H_2][I_2]} = \frac{(0,369+2x)^2}{(0,298-x)(0,41-x)} = 54,3$$

$$50,3x^2 - 39,9x + 6,48 = 0$$

Ka kuptim vlera më e vogël e  $x = 0,228$

- $[H_2] = (0,298 - 0,228) \text{ M} = 0,070 \text{ M}$
- $[I_2] = (0,410 - 0,228) \text{ M} = 0,182 \text{ M}$
- $[HI] = [0,369 + 2(0,228)] \text{ M} = 0,825 \text{ M}$

b) Ekuilibri zhvendoset majtas nëse:

Rritet përqendrimi i  $HI$ , ose zvogëlohen përqendrimet e hidrojenit ose jodit.

Ndryshimet në trysni nuk e zhvendosin ekuilibrin që ka numër të njëjtë molesh gas në të dyja anët e ekuilibrit.

Rritet e temperature, sepse ajo do të favorizojë zhvillimin e reaksiionit endotermik.

c)

$$V_{\text{drejtë}} = k_1[H_2][I_2]$$

$$V_{\text{zhdrejtë}} = k_2[HI]^2$$

4. Për të djegur  $100 \text{ cm}^3$  të një hidrokarburi të gaztë A, u përdorën saktësisht  $600 \text{ cm}^3$  oksigjen dhe u formuan  $400 \text{ cm}^3$  dioksid karboni dhe një sasi uji (djegie e plotë).
- Me anë të informacionit të vëllimeve të mësipërme përcaktoni formulën molekulare të hidrokarburit A.
  - Shkruani barazimin termokimik të reaksionit të djegies së hidrokarburit A duke njehuar ndryshimin e entalpisë me anë të energjive të lidhjeve kimike në  $\text{kJ/mol}$ . ( $E_{\text{C-C}} = 348$ ;  $E_{\text{C=C}} = 611$ ;  $E_{\text{C-H}} = 414$ ;  $E_{\text{O=O}} = 498$ ;  $E_{\text{C=O}} = 799$ ;  $E_{\text{H-O}} = 463$ )
  - Tregoni izomerët që ka gjithsej hidrokarburi A.
  - Shkruani një reaksiون për sintezën organike të një prej izomerëve të përbërjes A.






3 pikë

3 pikë

3 pikë


1 pikë

### Zgjidhje



$x=4; y = 8$  formula e hidrokarburit  $\text{C}_4\text{H}_8$

b)



Shuma e energjisë së përthithur për të këputur lidhjet te reakantët:  $7807 \text{ KJ}$

Shuma e enenergjisë së çliruar kur formohen lidhjet te produktet:  $10086 \text{ KJ}$

$\Delta H = 7807 \text{ KJ} - 10086 \text{ KJ} = -2279 \text{ KJ}$


Pranohet si zgjidhje edhe nëse djegia bëhet me një hidrokarbur të ngopur ciklik.

- c) 6 izomerë si hidrokarbur të ngopur dhe të pangopur:

Buten-1; cis-butén-2; trans-butén-2; metil propen; ciklobutan; metil ciklopropan

- d) Një reaksiون i mundshëm:

(pranohen edhe sinteza të tjera të mundshme)



5. Hidroliza me ujë e një esteri të panjohur X me varg hidrokarburi te ngopur, formon përbërjet Y dhe Z. Përbëra Y është një acid alcanoik me masë molekulare 74. Përbëra Z nuk mund të oksidohet dhe ka të njëjtën masë molekulare me acidin Y. ( $\text{Ar}_\text{C}=12$ ;  $\text{Ar}_\text{H}=1$ ;  $\text{Ar}_\text{O}=16$ )
- Përcaktioni formulën molekulare të acidit karboksilik Y
  - Përcaktioni formulën molekulare të përbërjes Z.
  - Shkruani formulën strukturore dhe emërtoni përbërjen Z.
  - Shkruani formulën strukturore dhe emërtoni përbërjen X.
  - Shkruani një reaksiون të mundshëm që sintetizon përbërjen Z.
  - Shkruani reaksiونin e hidrolizës së përbërjes X me një bazë alkaline.
  - Tregoni izomerët e përbërjes Y.
- |        |        |
|--------|--------|
| 1 pikë | 1 pikë |
| 1 pikë | 1 pikë |
| 2 pikë | 2 pikë |
| 2 pikë | 2 pikë |

### Zgjidhje

- Formula molekulare e acidit alcanoik Y  $\text{C}_n\text{H}_{2n}\text{O}_2$ :  $14n + 32 = 74$        $n = 3$ ;  $\text{C}_3\text{H}_6\text{O}_2$
- Formula molekulare e alkoolit Z  $\text{C}_n\text{H}_{2n+2}\text{O}$ :  $14n + 18 = 74$        $n = 4$ ;  $\text{C}_4\text{H}_{10}\text{O}$
- $\text{CH}_3\text{C}(\text{OH})(\text{CH}_3)_2$   
metil-2-propanol-2 (alkool tretësor)
- $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOC}(\text{CH}_3)_3$ ;  
Propanoat -t-butili
- Një sintezë e mundshme:  $\text{CH}_2=\text{C}(\text{CH}_3)_2 + \text{H}_2\text{O} \xrightarrow{\text{H}_2\text{SO}_4} \text{CH}_3\text{C}(\text{OH})(\text{CH}_3)_2$
- $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOC}(\text{CH}_3)_3 + \text{NaOH} \rightarrow \text{CH}_3\text{CH}_2\text{COONa} + \text{CH}_3\text{C}(\text{OH})(\text{CH}_3)_2$
- Acidi propanoik  $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOH}$  ka dy estere izomere: etanoat metili dhe metanoat etili  
 $\text{CH}_3\text{COOCH}_3$  dhe  $\text{HCOOCH}_2\text{CH}_3$